

VENDIM
Nr. 132, datë 20.2.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“BY-PASS SHKOZET, DURRËS”, OBJEKTET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-pass Shkozet, Durrës”, objektet.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për objekte me vlerë 208 517 924 (dyqind e tetë milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale në vlerën 806 000 (tetëqind e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 208 517 924 (dyqind e tetë milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2013 “Zëri i shpronësimeve”, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
 6. Shpronësimi të fillojë në datën 28.2.2013.
 7. Për objektet për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “leje ndërtimi”, pronarët të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë dorëzuar pranë ARSH-së dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor.
 8. Për objektet për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “proces legalizimi”, poseduesit e këtyre objekteve të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të vendimit nr. 563, datë 3.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.
 9. Për objektet për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, pronarët të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë të rifreskuar, të cilin do ta dorëzojnë pranë ARSH-së.
 10. ARSH-ja të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 7, 8 dhe 9 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.
 11. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
 12. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen: procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha